

VENDIM
Nr. 319, datë 8.11.2023

**MBI KËRKESAT E SHOQËRIVE PËR ZGJIDHJEN E MOSMARRËVESHJES
NDËRMJET PALËVE: “TREN SUN SYSTEM” SHPK, “SUN BEAT SYSTEM” SHPK,
NTSP SHPK, “KORCA PHOROVOLTAIC PARK” SHPK DHE SHOQËRISË
FURNIZUESI I TREGUT TË LIRË SHA**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 20, geramat “a” dhe “ë”, nenit 24, pikat 1, 2, 3 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 15 dhe 23 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 3.9.2016; nenit 11, pika 4, të “Rregullores për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve, në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 114, datë 8.7.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 8.11.2022, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga grupi i punës me nr. 1919/4 prot., datë 6.11.2023, “Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e mosmarrëveshjes ndërmjet FTL sh.a. dhe shoqërive: ‘Tren Sun System’ sh.p.k., ‘Sun Beat System’ sh.p.k., NTSP sh.p.k., ‘Korca Phorovoltaic Park’ sh.p.k.”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Tren Sun System” sh.p.k., nëpërmjet shkresës së protokolluar në ERE me nr. 1918, datë 13.7.2023; shoqëria “Sun Beat System” sh.p.k., nëpërmjet shkresës së protokolluar në ERE me nr. 1919, datë 13.7.2023; shoqëria “Korca Phorovoltaic Park” sh.p.k., nëpërmjet shkresës së protokolluar në ERE me nr. 1920, datë 13.7.2023; shoqëria NTSP sh.p.k., nëpërmjet shkresës së protokolluar në ERE me nr. 1921, datë 13.7.2023, ndër të tjera parashtrojnë kërkesën si vijon: ... “vlerësojmë/paraqesim qëndrimin tonë, se duke qenë se energjia e prodhuar nga këto centrale fotovoltaike përgjatë periudhës nga 28.7.2022 deri më 8.11.2022 ka shkuar për nevojat e përmbushjes së detyrimit publik, duhet të njihet dhe t’i paguhet shoqërisë”.

- Të katërta shoqëritë e sipërcituara paraqesin të njëjtën problematikë, e cila lidhet me njohjen dhe pagesën e energjisë elektrike të gjeneruar nga njësitë fotovoltaike që këto shoqëri zotërojnë përgjatë periudhës 28.7.2022 deri më datë 8.11.2022.

- ERE, më datë 26.9.2023, organizoi një seancë dëgjimore, ndërmjet përfaqësuesve të shoqërive: “Tren Sun System” sh.p.k., “Sun Beat System” sh.p.k., NTSP sh.p.k., “Korca Phorovoltaic Park” sh.p.k., si dhe të shoqërive OSSH sh.a. dhe FTL sh.a., me objekt: Trajtimin e problematikës së ngritur nga shoqëritë: i. “Tren Sun System” sh.p.k.; ii. “Sun Beat System” sh.p.k.; iii. NTSP sh.p.k.; iv. “Korca Phorovoltaic Park” sh.p.k., mbi prodhimin e livruar dhe të pakontraktuar nga njësitë gjeneruese fotovoltaike në zotërim të këtyre shoqërive”.

- Në këtë seancë dëgjimore rezultoi që shoqëritë “Tren Sun System” sh.p.k., “Sun Beat System” sh.p.k., NTSP sh.p.k., “Korca Photovoltaic Park” sh.p.k., nuk kishin ezauruar të gjithë hapat administrativë, por kishin pasur një komunikim të drejtpërdrejtë për këtë problematikë me FTL sh.a., por i ishin drejtuar ERE-s dhe vetëm kishin vënë në dijeni FTL sh.a. Në këto rrethana, ERE vlerësoi që palët të kishin një komunikim të drejtpërdrejtë, duke shprehur dhe qëndrimet përkatëse.

- Shoqëria FTL sh.a., nëpërmjet shkresës me nr. 2834/4 prot., datë 11.10.2023, drejtuar shoqërisë “Tren Sun System” sh.p.k., me shkresën nr. 2834/2 prot., datë 11.10.2023 drejtuar shoqërisë “Sun Beat System” sh.p.k., me shkresën me nr. 2834/1 prot., datë 11.10.2023 drejtuar shoqërisë “Korca Phorovoltaic Park” sh.p.k., me shkresën me nr. 2834/3 prot., datë 11.10.2023 drejtuar shoqërisë NTSP sh.p.k., ka parashtruar sa më poshtë vijon: “... për periudhën e kërkuar 28.7.2022–8.11.2022, shoqëria FTL sh.a. nuk ka pasur kontratë shitblerje të energjisë elektrike me shoqërinë... Kontrata ndërmjet shoqërisë... dhe FTL sh.a. ... për shitblerjen e energjisë elektrike të prodhuar nga centrali fotovoltaike, është lidhur me datë 28.4.2023, dhe ka hyrë në fuqi më datë 2.5.2023, datë e cila

korrespondon me fillimin e operimit/livrimin të energjisë elektrike, siç përcaktuar në aneksin e kontratës.”

- Në vijim të këtij komunikimi shoqëritë: i. “Tren Sun System” sh.p.k.; ii. “Sun Beat System” sh.p.k.; iii. NTSP sh.p.k.; iv. “Korca Photovoltaic Park” sh.p.k., nëpërmjet shkresave përkatëse drejtuar në ERE kanë parashtruar, si më poshtë vijon: “... Në vijim ne kemi paraqitur kërkesën tonë pranë FTL sh.a. për dijeni ERE-s dhe OSSH-së më datë 3.10.2023, së cilës FTL i është përgjigjur me shkresë më datë 11.10.2023. Duke qenë se nuk jemi të qartë për zgjidhjen e kërkesës sonë nga FTL-ja, kërkojmë nga institucioni juaj që të mund ta ndiqni ju këtë çështje me FTL sh.a., në formë shkresore, kërkesën tonë për njohjen dhe blerjen e energjisë së prodhuar për periudhën 28.7.2022 deri më 8.11.2022. Edhe njëherë, në këto kushte, kërkojmë nga ana juaj trajtimin e mëtejshëm të kërkesës sonë nga institucioni juaj.”

- Duke qenë se palët FTL sh.a. dhe shoqëritë: i. “Tren Sun System” sh.p.k.; ii. “Sun Beat System” sh.p.k.; iii. NTSP sh.p.k.; iv. “Korca Photovoltaic Park” sh.p.k., të cilat ngrenë një problematikë të njëjtë për energjinë e prodhuar nga centralet fotovoltaike që zotërojnë këto shoqëri përgjatë periudhës nga 28.7.2022 deri më 8.11.2022, kanë qëndrime të kundërta me FTL sh.a.; ERE në mbështetje të legjislacionit në fuqi, me urdhrin nr. 102, datë 31.10.2023 ka ngritur një grup pune për të trajtuar problematikën/mosmarrëveshjen ndërmjet shoqërive: i. “Tren Sun System” sh.p.k.; ii. “Sun Beat System” sh.p.k.; iii. NTSP sh.p.k.; iv. “Korca Photovoltaic Park” sh.p.k., si dhe të shoqërisë FTL sh.a., mbi prodhimin e livruar dhe të pakontraktuar nga njësitë gjeneruese fotovoltaike të këtyre shoqërive.

- Duke marrë në konsideratë se palët: i. “Tren Sun System” sh.p.k.; ii. “Sun Beat System” sh.p.k.; iii. NTSP sh.p.k.; iv. “Korca Photovoltaic Park” sh.p.k., janë të licencuara për prodhimin e energjisë elektrike dhe shoqëria dhe FTL sh.a., është e licencuar në furnizimin e energjisë elektrike, në zbatim të nenit 11 të “Rregullores për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve, në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 114, datë 8.7.2016, legjitimohen për të kërkuar zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet tyre mbi prodhimin e livruar dhe të pakontraktuar nga njësitë gjeneruese fotovoltaike të shoqërive të sipërcituara.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pranimin për shqyrtim nga ERE të kërkesës së paraqitur nga shoqëritë “Tren Sun System” sh.p.k., “Sun Beat System” sh.p.k., NTSP sh.p.k., “Korca Photovoltaic Park” sh.p.k., për zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet shoqërive dhe shoqërisë FTL sh.a., duke filluar procedurën për zgjidhjen e mosmarrëveshjes në përputhje me “Rregulloren për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 114, datë 8.7.2016.

2. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

